

Vendim nr. 181 datë 10.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 10.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (F) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FADIL ZENELI**, përfaqësuar nga avokatja Agathi Kukeli, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 3010, datë 28.06.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-5134, datë 18.12.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, 17, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 39, 49, 71, 71/a dhe 76, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi bashkë me familjen e tij kanë qenë banorë të fshatit Bruzë Zallë, Komuna Cudhi, Krujë. Në vitin 1993 kërkuesi është pajisur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (*AMTP*) nr. 48, datë 15.01.1993, nga Komisioni i Ndarjes së Tokës (*KNT*) të fshatit Rranzë (Komuna Cudhi), për një sipërfaqe toke prej 6844 m². Ndërkohë, me ndërtimin e Ujëmbledhësit të Bovillës në vitin 1994, u përmbytën tokat e banorëve të lagjes Faresh (Kumradhë), fshati Bruzë Zallë dhe fshati Ranzë, ndër to toka dhe shtëpia e kërkuesit.

2. Me VKM-në nr. 85, datë 02.03.1994 “Për vënien në dispozicion të zonave të banimit, për familjet që shpërngulen nga Ujëmbledhësi i Bovillës dhe ato që kanë ndërtuar pa leje përreth qytetit të Tiranës” (*VKM-ja nr. 85/1994*), Këshilli i Ministrave (*KM*) ka vendosur shpërnguljen e familjeve të përmbytura nga Ujëmbledhësi i Bovillës, në zonën e Bathores me sipërfaqe 200 ha dhe në zonën e Babrrusë me sipërfaqe 50 ha, duke ngarkuar Këshillin e Rrethit Tiranë dhe atë Krujë, që brenda muajit mars të vitit 1994, të përcaktojnë numrin e saktë të familjeve që do të shpërngulen, duke evidentuar numrin e frymëve, të banesave, sipërfaqes së banesës dhe truallit për çdo familje, si dhe zonën ku do të vendosen.

3. Në zbatim të VKM-së nr. 85/1994 dhe në mungesë të ligjit të posaçëm, KM-ja, me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit (më pas Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës), me vendimin nr. 317, datë 19.06.1995 “Për sistemimin me tokë bujqësore dhe truall ndërtimi të fshatrave Zallmner, Bulçesh dhe Bruzë Zallë” (*VKM nr.317/1995*), ka përcaktuar sistemimin e banorëve të fshatit Bruzë Zallë në parcelat me numra 52, 54, 56, 57, 50, 51, 206 dhe 211 me sipërfaqe të përgjithshme 34 ha tokë bujqësore dhe në parcelën nr. 136 me sipërfaqe të përgjithshme 2 ha, zonë urbane në Komunën e Paskuqanit.

4. Në vijim, në zbatim të VKM-së nr. 85/1994, familja e kërkuesit është shpërngulur në fshatin Babrru, Komuna Paskuqan në një sipërfaqe tokë arë prej 7438 m², dhënë nga KNT-ja pranë Këshillit të Rrethit Tiranë, e cila më pas është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit

të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë dhe kërkuesi është pajisur me certifikatë pronësie në datën 09.01.2001.

5. Në zbatim të VKM-së nr.317/1995 u nënshkrua protokoll-marrëveshja e datës 16.01.1998, ndërmjet përfaqësueseve të disa institucioneve si Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit (MBU), Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT), Korporatës Energjetike Shqiptare, Sekretariati i Shtetit për Pushtetin Lokal, Prefektura Tiranë, Prefektura Durrës, Këshilli i Rrethit Tiranë dhe Këshilli i Rrethit Durrës, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Kamëz, si dhe komunat përcjellëse dhe pritëse. Në pikën 8 të protokoll-marrëveshjes është përcaktuar se Këshilli i Rrethit Tiranë dhe Komuna Zallbstar duhet t'i paraqesin MPPT-së brenda datës 30.01.1998 propozimin për kompensimin e tokës bujqësore, në mënyrë që MPPT-ja t'ia paraqesë KM-së për shqyrtim.

6. Këshilli i Rrethit Tiranë, me shkresën e datës 19.02.1998, i ka dërguar MBU-së dokumentacionin për zbatimin e protokoll-marrëveshjes, bashkëlidhur listën e familjeve të pajisura me tokë bujqësore në fshatin Babrru (ndër të cilët figuronte dhe kërkuesi me numër rendor 6, me sipërfaqe toke në pronësi 8400 m², kategoria e tokës V).

7. Në vijim, meqenëse Komuna Paskuqan nuk dispononte tokë të mjaftueshme për kompensimin e banorëve, me shkresën e datës 03.04.1998, Këshilli i Rrethit Tiranë ka informuar MPPT-në se 24 familje të këtij fshati kanë marrë 1400 m² për frymë nga 1800 m² për frymë që përcakton VKM-ja nr. 317/1995 dhe për këtë arsye është kërkuar kompensim në vlerë monetare nga familjet e fshatit Brurëz të pajisur me tokë bujqësore. Me shkresën e datës 22.09.1998, Këshilli i Rrethit Tiranë i drejtohet sërish MPPT-së, Sektorit të Shpronësimeve, me kërkesë për kompensim financiar për sipërfaqen e mbetur pa u kompensuar për shkak se Komuna Paskuqan nuk disponon tokë të lirë. Meqenëse sipërfaqja e përfituar për disa nga këto familje nuk përbënte kompensim të plotë fizik, duke u vlerësuar mosplotësimi i normës për frymë prej 1800 m², kjo referuar nga ish-Këshilli i Rrethit Tiranë, sipërfaqes së përgjithshme të caktuar me VKM-në nr. 317/1995 dhe numrit të banorëve, janë ndërmarrë një sërë veprimesh dhe korrespondencash ndër vite nga institucionet shtetërore për mundësinë e realizimit të kompensimit financiar të kërkuar.

8. Në vitin 2000 Komuna Paskuqan i është drejtuar me kërkesë MPPT-së për zgjidhjen e problemit të kompensimit financiar, duke kërkuar pozicionimin e MPPT-së për zgjidhjen përfundimtare të likuidimit në vlerë monetare. Me shkresën e datës 03.06.2002 sekretari i përgjithshëm i KM-së ka informuar Komunën Paskuqan se pranë KM-së gjendej për miratim një

projektvendim, efektet financiare të të cilit do të përballoheshin nga fondi rezervë, duke sjellë negocimin dhe, për rrjedhojë, mbajtjen pezull të tij.

9. Me shkresën e datës 04.06.2002 Drejtoria Juridike e ish-Ministrisë së Rregullimit të Territorit (*MRTT*) (Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës) ka informuar KM-në se në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga Komuna Paskuqan, 32 familje nuk janë kompensuar për 90.8000 m² tokë që kapin vlerën 54.480.000 lekë, për shkak se 24 familje me 142 banorë janë kompensuar 400 m² më pak për frymë ndërsa familjet e tjera me 49 banorë me 700 m² tokë më pak për frymë, duke e vlerësuar të drejtë kërkesën për kompensim financiar për sipërfaqen prej 90.800 m² me një çmim prej 6.000 lekësh/m², në bazë të VKM-së nr. 324, datë 05.05.2000, si dhe hartimin e një projektvendimi për t'u miratuar në Këshillin e Ministrave. Në vijim, me urdhrin nr. 92, datë 27.06.2003 (*UKM-ja nr.90/2003*) të KM-së është ngritur grupi i punës për trajtimin e problemeve të banorëve të shpërngulur, si rezultat i ndërtimit të Ujëmbledhësit të Bovillës, të cilët nuk ishin kompensuar. Ndërkohë në datën 28.06.2005, MRTT-ja, dërgon për miratim në KM një projektvendim, në pikën 2 të të cilit është përcaktuar se pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, kompensohen sipas masës që paraqiten në listën që i bashkëngjitet vendimit për sipërfaqen prej 90.800 m² tokë bujqësore të vlerësuar në shumën e përgjithshme 54.480.000 lekë. Po kështu, MRTT-ja, me shkresën e datës 27.07.2005, ka njoftuar Kryetarin e Komunës Paskuqan se, si rezultat i konkluzioneve të dala nga grupi i punës, janë nisur dy projektvendime ku parashikohet kompensimi i familjeve të fshatit Bruzë.

10. Me shkresën e datës 08.02.2008, Komisioni i Posaçëm pranë Sektorit të Shpronësimeve të MPPT-së i ka kërkuar Komunës Paskuqan, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”, të paraqesë kërkesë për shpronësim pranë MPPT-së, e cila duhet të përmbajë listën e pronarëve të konfirmuar nga ZVRPP-ja, ku të pasqyrohen numri i pasurisë dhe sipërfaqet respektive për çdo pronar, dokumentacionin për kompensimin me tokë bujqësore për secilën familje, të shoqëruar me numrin e frymëve dhe masën respektive të kompensimit, pasi procedurat për kompensim të 32 familjeve, të cilat datojnë nga viti 1999 deri në vitin 2003, janë pezulluar për mungesë fondesh.

11. Në vijim, nga Komisioni i Posaçëm nuk u arrit një vendimmarrje përfundimtare për arsye të paqartësive dhe mangësive të dokumentacionit të paraqitur nga komunat Paskuqan dhe Cudhi. Në korrespondencën e Komisionit të Posaçëm me këto komuna nënvizohet se në VKM-

në nr. 317/1995 nuk përcaktohet në asnjë pikë të saj se familjeve të shpërngulura do t'u kompensohet një sipërfaqe prej 1.800 m²/frymë, por përcaktohen vetëm sipërfaqet e shprehura në hektarë që do të kalojnë nën administrimin e komunave Kamëz dhe Paskuqan për sistemimin me tokë bujqësore dhe truall ndërtimi të banorëve të fshatrave të prekura, për rrjedhojë të dhënat për sipërfaqet për kompensim për frymë për 24 familjet në listat e komunave nuk përputhen me konfirmimin e dhënë nga ZVRPP-ja, Tiranë.

12. Ndërkohë, Komisioni i Posaçëm i MPPT-së, me kërkesën e datës 22.06.2009 “Për shpronësim publik”, i është drejtuar Komunës Paskuqan për të afishuar kërkesën për shpronësim me qëllim vënien në dijeni të personave të prekur nga shpronësimi për masën e vlerësimit të llogaritur nga ky komision. Sipas listës së afishuar, kërkuesi ka rezultuar me numër rendor 6, me sipërfaqe të mbetur pa u kompensuar sipas listës së Komunës Paskuqan në masën 3.362 m² dhe me vlerë kompensimi 1.970.132 lekë. Në vijim, kërkesa e MPPT-së nr. 4060, datë 22.06.2009, rezulton të jetë botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 24 korrik 2009. Komisioni i Posaçëm më 16.07.2009 ka miratuar kompensimin e 24 familjeve, ndër të cilat edhe kërkuesi.

13. Në datën 22.07.2013 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt: (i) detyrimin e palëve të paditura, KM-së dhe MPPTT-së, ta kompensojnë për pjesën e pasurisë së pa dhënë sipas VKM-së nr.137/1995; (ii) detyrimin e palëve të paditura ta kompensojnë në vlerë monetare prej 1.970.132 lekësh (e përcaktuar nga pala e paditur, si dhe e publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 131, datë 24 korrik 2009), për pronën e shpronësuar në fshatin Ranzë, me sipërfaqe prej 3362 m².

14. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1593, datë 05.02.2014, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr.5932, datë 24.10 2014, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palëve të paditura, MTI-së dhe KM-së ta kompensojnë kërkuetin me vlerën 1.970.132 lekë për pronën e shpronësuar në fshatin Ranzë. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim pala e paditur MTI-ja dhe Avokatura e Shtetit.

15. Në datën 12.05.2017 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me një kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues me pretendimin se ky trup gjykues ka gjykuar dy çështje analoge me të njëjtën palë të paditur e me të njëjtin objekt dhe ka vendosur në kundërshtim me vendimin nr.00-2015-3342 (296), datë 12.05.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Me vendimin nr. 196, datë 25.05.2017, Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të

përbërë nga tre gjyqtarë, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues me arsyetimin se nuk rezulton të jetë dhënë mendim nga trupi gjykues për çështjen në gjykim, madje vetë kërkuesi e ka paragjykuar trupin gjykues pa filluar ende procesi.

16. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.3010, datë 28.06.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

17. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5134, datë 18.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit pasi nuk përmbushte kërkesat e nenit 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

18. Në datën 15.04.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000, është regjistruar më 24.04.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuetit

19. **Kërkuesi**, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

19.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

19.1.1 *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike, parimit të transparencës, parimit të ligjshmërisë, parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, parimit të objektivitetit në shqyrtimin e rasteve*, pasi Kolegji Administrativ, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, e ka shqyrtuar çështjen në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë, duke marrë vendime të ndryshme në raste analoge.

19.1.2 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë vendimin për mospranimin e rekursit e ka arsyetuar ndryshe

nga praktika e Kolegjit Administrativ. Konkretisht, Kolegji Administrativ, me vendimin nr. 296, datë 12.05.2015, ka arritur në përfundimin se ndodhej përpara një të drejte pronësie të mbrojtur me ligj, ndërsa në rastin konkret Gjykata e Lartë ka injoruar ekzistencën e fakteve dhe të pretendimeve të ngritura nga kërkuesi dhe nuk ka arsyetuar vendimmarrjen e saj për kompensimin e pronës së shpronësuar, duke i mohuar edhe të drejtën e aksesit substancial në gjykatë. Gjykata e Lartë dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk kanë pasqyruar aspak rrethanat e çështjes, duke mbajtur një qëndrim subjektiv në analizimin e tyre.

19.2. *Parimit të paanshmërisë së gjyqtarëve dhe objektivitetit*, pasi Gjykata e Lartë duhet të prishte vendimin e gjykatës së apelit që ka rrëzuar kërkesën e tij për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues të cilët kanë shfaqur mendim për çështje të tjera analoge.

III

Vendimi i Kolegjit

A. *Për legjitimimin e kërkuesit*

20. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

21. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është

palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

22. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

23. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 18.12.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 15.04.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

24. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji vëren se pavarësisht parimeve dhe të drejtave të pretenduara të cenuara, nisur nga thelbi i argumenteve, kërkuesi ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me të drejtën e aksesit, si dhe të parimit të paanshmërisë.

25. Fillimisht, Kolegji konstaton se kërkuesi për pretendimin për cenimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk ka parashtruar argumente për të provuar këtë pretendim. Në thelb, pretendimet e tij janë të lidhura me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, pasi, sipas tij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim në kundërshtim me vendime të tjera të atij kolegji dhe me praktikën e Gjykatës së Lartë në raste analoge.

26. Lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastet e ekzistencës të disa vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për interpretimin e

ligjit, Gjykata është shprehur se ky fakt nuk mund të sjellë pritshmëri të ligjshme të kërkuarit për zbatimin e ligjit, në kushtet kur nuk është kryer një interpretim unifikues ose njëses për të (*shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata është shprehur se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes të çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur ndryshe në disa raste të ngjashme, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Kolegji konstaton se vendimet e referuara nga kërkuari në ankimin kushtetues individual parashtrojnë rrethana të njëjta me ato të kërkuarit në raport me kërkesën për dëmshpërblim për shkak të përmbytjes së tokës bujqësore dhe për shkak të ndërtimit të Ujëmbledhësit të Bovillës. Megjithatë, edhe pse këto raste janë të ngjashme, nuk janë vendime njëse të Gjykatës së Lartë, duke mos qenë të detyrueshme për zbatim nga gjykatat më të ulëta, ndaj argumentet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit janë të pamjaftueshme për të krijuar pritshmëri të ligjshme. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi është haptazi i pabazuar.

28. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuarit në drejtim të parimit të paanshmërisë dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit, të cilat *prima facie* janë me natyrë kushtetuese, ato do të analizohen në vijim nga Kolegji.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

29. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë duhet të prishte vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit që ka rrëzuar kërkesën e tij për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues, të cilët kanë shfaqur mendim për çështje të tjera analoge.

30. Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, po kështu, ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari

për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 15, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual rezulton se kërkuesi ka ngritur pretendime për paanshmërinë e trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, të ngarkuar me shqyrtimin e ankimit të palës kundërshtare me kërkuesin në procesin gjyqësor, duke kërkuar që anëtarët e tij të mos marrin pjesë në shqyrtim, me pretendimin se ai trup gjykues në disa raste të mëparshme analoge, në çështje të tjera, ka rrëzuar kërkesat e tyre për kompensim financiar për pronën e shpronësuar, në kundërshtim me vendimin nr.00-2015-3342 (296), datë 12.05.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndaj nisur nga fakti se trupi gjykues mund të mbajë të njëjtin qëndrim, kërkesa në rastin konkret duhet të gjykohej nga një trup gjykues i cili premtonte një vendimmarrje të drejtë. Duke vlerësuar se nga kërkuesi është kërkuar përjashtimi i trupit gjykues, kjo kërkesë është shqyrtuar nga një tjetër trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili, me vendimin nr. 196, datë 25.05.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtim të trupit gjykues me arsyetimin se nuk rezulton të jetë dhënë mendim nga trupi gjykues për çështjen në gjykim, madje vetë kërkuesi e ka paragjykuar trupin gjykues pa filluar ende procesin.

32. Për sa më lart, Kolegji konstaton se kërkesa e kërkuesit për përjashtimin e trupit gjykues është shqyrtuar rregullisht, duke u gjetur e pabazuar, ndërsa gjykata e apelit ka parashtruar argumentet përkatëse në këtë drejtim. Pavarësisht faktit se trupi gjykues ka gjykuar kërkesa të tjera analoge, Kolegji vlerëson se vetëm këto argumente nuk janë të mjaftueshme për të vënë në dyshim respektimin e parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, për rrjedhojë pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit

33. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë me mospranimin e rekursit ka arsyetuar ndryshe nga praktika e Kolegjit Administrativ, i cili, me vendimin nr. 296, datë 12.05.2015, ka

arritur në përfundimin se ndodhej përpara një të drejte pronësie të mbrojtur me ligj. Gjykata e Lartë e ka injoruar ekzistencën e fakteve dhe të pretendimeve të ngritura nga kërkuesi. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar vendimmarrjen e saj për kompensimin e pronës së shpronësuar, duke i mohuar të drejtën e aksesit substancial në gjykatë. Gjykata e Lartë dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk kanë pasqyruar aspak rrethanat e çështjes, duke mbajtur qëndrime subjektive në analizimin e tyre.

34. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse mohohet e drejta e aksesit, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, përpara së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 16, datë 23.03.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjithashtu, sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyeimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 19.01.2018; nr.25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Po kështu, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me

konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në rastin në shqyrtim Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi i cili ka kërkuar detyrimin e palëve të paditura, KM-së dhe MPPTT-së, ta kompensojnë për pjesën e pasurisë të pa dhënë sipas VKM-së nr.137/1995, si dhe detyrimin e palëve të paditura ta kompensojnë në vlerë monetare prej 1.970.132 lekësh (e përcaktuar nga pala e paditur, si dhe e publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 131, datë 24 korrik 2009), për pronën e shpronësuar në fshatin Ranzë, me sipërfaqe prej 3362 m².

38. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.5932, datë 24.10.2014, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palëve të paditura, MTI-së dhe KM-së, ta kompensojnë kërkuesin me vlerën prej 1.970.132 lekësh për pronën e shpronësuar në fshatin Ranzë, me arsyetimin se nga ana e organeve shtetërore janë nxjerrë aktet nënligjore përkatëse, si dhe janë kryer një sërë veprimesh administrative për kompensimin me tokë dhe në lekë të familjeve të shpronësuar nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës, ndër to edhe kërkuesi, por nga ana e palëve të paditura nuk është përmbushur deri në fund ky detyrim ligjor për të kryer shpronësimin efektiv të tij (dëmshpërblimin), për shkak të përmbytjes së pasurisë. Ajo gjykatë ka vlerësuar se vlera e dalë nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit dhe e shpallur publikisht në vlerën 1.970.132 lekë, përbën vlerën reale të kësaj pasurie të shpronësuar dhe që përmbush interesat ligjorë të kërkuesit. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim pala e paditur MTI-ja dhe Avokatura e Shtetit.

39. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.3010, datë 28.06.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin se kërkuesi, si një nga familjet e përmbytura nga Ujëmbledhësi i Bovillës është shpërngulur me banim dhe është pajisur me tokë nga Komisioni i Ndarjes së Tokës pranë Këshillit të Rrethit Tiranë, e cila, referuar certifikatës së regjistrimit lëshuar nga ZVRPP-ja, Tiranë, në datë 09.01.2001, ka

rezultuar në masën prej 7.438 m², regjistruar pasuria në zonën kadastrale nr.1066, e ndodhur në Babrru, Tiranë, sipërfaqe që është më e madhe sesa ajo prej 6844 m², dhënë kërkuesit me AMTP-në nr. 48, datë 15.01.1993, në fshatin Rranzë. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka vlerësuar se pretendimi i paditësit për kompensim sipas VKM-së nr.317/1995 është i pabazuar, pasi në këtë të fundit nuk rezulton asnjë përcaktim për normën për frymë dhe zgjidhja e qeverisë sipas VKM-së nr.317/1995 rezulton të jetë bazuar në sipërfaqen e disponueshme dhe të caktuar për këtë qëllim në përmbushje të detyrimit të lindur nga neni 19 i ligjit për tokën. Pra, kjo e fundit nuk rezulton të jetë përcaktuar në bazë të një norme për frymë, por mbi gjendjen e disponueshme. Sipas asaj gjykate, argumentimi i përmbajtur në shkresat e Komunës Paskuqan dhe të ish-Këshillit të Rrethit Tiranë, se nuk disponohet më tokë për pajisjen me 1800 m² për frymë, rezulton të jetë pa bazë ligjore, pasi KM-ja në VKM-të nr.85/1994 dhe nr.137/1995 nuk ka asnjë përcaktim të tillë, ndërkohë që vendos për sipërfaqen e përgjithshme që do të vihet në dispozicion për familjet e përmbytura, madhësinë e tyre, si dhe kategorizimin e vendosjes së familjeve të përmbytura sipas fshatit dhe, në vijim, me komunat që përfshihen në sistemimin me tokë bujqësore dhe truall për ndërtim të këtyre familjeve. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

40. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5134, datë 18.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit pasi nuk përmbush kërkesat e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012. Sipas Kolegjit Administrativ, nga vlerësimi i rrethanave të mosmarrëveshjes objekt gjykimi të konstatuara nga gjykatat e faktit, kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë argument të qenësishëm që të lidhet me një nga shkaqet për të cilat mund të ushtrohet e drejta e rekursit dhe se nuk është rasti për të vënë në diskutim ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet kryesisht nga gjykata.

41. Nga sa më lart, Kolegji vlerëson se referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, objekt kërkesë, ato i përmbushin elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit, pasi kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e ngritjes së padisë dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimin e saj. Vendimi i kundërshtuar i gjykatës së apelit tregon mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ajo, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ajo gjykatë është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Gjykata e apelit ka vlerësuar provat dhe pretendimet e

kërkueses në lidhje me kërkesën për kompensim financiar, porse në analizë të provave të administruara në gjykim, si dhe ligjit të zbatueshëm, ajo gjykatë ka arritur në përfundime jo të njëjta me pretendimet e kërkuarit. Në këndvështrim të standardit të arsyetimit, Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit të paraqitura nga kërkuari, ka arsyetuar se përse nuk bëjnë pjesë në ato të parashikuara nga neni 58 të ligjit nr.49/2012, duke e vlerësuar të drejtë vendimmarrjen dhe arsyetimin e gjykatës së apelit. Vendimet nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore ose të paqarta në përmbajtjen dhe vlerësimin e tyre. Për sa kohë nga kërkuari nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës, vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të tij, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me të drejtën e aksesit.

42. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit është haptazi i pabazuar.

43. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.